



**VENDIM**

*Nr. 154, Datë 06.10.2016*

**PËR**

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “XHENGO ENERGJI” SH.P.K, NË  
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HEC “KASOLLET E SELCËS” ME FUQI TË INSTALUAR 4000 KW**

Ne mbeshitetje te neneve 16; nenit 37, pika 2, germa “a”; të Ligjit Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 21 te “Rregullores per procedurat dhe afatet per dhenien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave ne sektorin e energjise elektrike” te miratuar me Vendimin e Bordit te ERE-s, Nr. 109, date 29.06.2016; dhe nenit 15 të “Rregullores per Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, date 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin per licensimin e shoqerise “XHENGO ENERGI” sh.p.k, ne aktivitetin e Prodhimit te Energjise Elektrike nga Hec ”Kasollet e Selces”, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “XHENGO ENERGI” sh.p.k., plotëson teresisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregullores per procedurat dhe afatet per dhenien, modifikimin, tranferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave ne sektorin e energjise elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni tekniko – ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Licensimin e shoqërisë “XHENGO ENERGJI” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kasollet e Selces” me fuqi 4000 KW, për një afat 30 - vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**